

VENDIM
Nr.19, datë 17.6.1997

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Rustem Gjata,	Kryetar i Gjykatës Kushtetuese
Hilmi Dakli,	Anëtar i “““
Manol Konomi,	Anëtar i “““
Veli Budo,	Anëtar i “““
Zija Vuci,	Anëtar i “““
Halil Kopani,	Anëtar i “““
Kristofor Peçi,	Anëtar i “““
Alfred Karamuco,	Anëtar i “““
Franc Jakova	Anëtar i “““

me sekretare Drita Filto, më datë 16.6.1997 mori në shqyrtim në seancë gjyqësore me dyer të hapura çështjen nr .23 Akti që i përket :

K Ë R K U E S: PREÇ ZOGAJ, i dtl. 5.12.1957, banues në Tiranë, Rr." Ali Banushi", Pall. 7, Ap.48.

O B J E K T I:

Shfuqizimi si antikushtetues i vendimit nr.9, datë 25. 4.1996 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Kasacionit dhe vendimit nr.5, datë 9.4.1996 të Komisionit Shtetëror për Kontrollin e Figurës së Zyrtarëve dhe Personave të tjerë.

GJYKATA KUSHTETUESE, pasi dëgjoji kërkuesin dhe shqyrtoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

Kërkuesi Preç Zogaj ka paraqitur kandidaturën e tij për deputet në Kuvendin Popullor të Republikës së Shqipërisë në zgjedhjet e 26 majit 1996.

Në zbatim të ligjit nr.8043, datë 30.11.1995 "Për kontrollin e figurës së zyrtarëve dhe personave të tjerë që lidhen me mbrojtjen e shtetit demokratik", Komisioni Shtetëror i ngarkuar për kontrollin e këtyre figurave, me vendimin nr.5, datë 09.04.1996 është shprehur se kërkuesi nuk mund të kandidohet për deputet në zgjedhjet e vitit 1996, sepse ka figuruar si agjent i Sigurimit të Shtetit në nr.1759, të Degës së Punëve të Brendshme Lezhë dhe nr.8532 të Degës së Punëve të Brendshme Tiranë.

Vendimin e Komisionit Shtetëror, kërkuesi e ka atakuar në Gjykatën e Kasacionit, ku ka parashtruar se është e vërtetë që pa mbushur 18 vjeç, në vitin 1975, ai ka firmosur një dokument me anën e të cilit bëhej informator i Sigurimit të Shtetit, por informatat që ka dhënë nga ajo kohë e deri në vitin 1983, kanë qenë të parëndësishme dhe nuk kanë dëmtuar persona të tjerë, ndërsa nga viti 1983 e ka ndërprerë krejtësisht këtë veprimtari.

Kolegji Civil i Gjykatës së Kasacionit, në vendimin e tij nr.9, datë 25.4.1996, pasi ka shqyrtuar një sërë provash dokumentare, i ka pranuar të vërteta pretendimet e kërkuesit se gjatë viteve të fundit të diktaturës, ai i është kundërvënë asaj me anën e një sërë veprash letrare e artikujsh me frymë kontestuese dhe denoncuese dhe në Konferencën e Shkrimtarëve të Rinj, të mbajtur në Korçë, në tetor të vitit 1990, ka kritikuar hapur tezën e Enver Hoxhës se: "shkrimtarët dhe artistët janë ndihmës të partisë në edukimin komunist të masave". Ky kolegji ndonëse ka arritur në konkluzionin se kërkuesi me aktivitetin e tij para datës 31.3.1991 ka vepruar kundër vijës zyrtare, megjithatë ka rrëzuar kërkesën e tij me arsyetimin se kërkuesi nuk ka plotësuar kushtin tjetër të gërmës "ç" të nenit 2 të Ligjit nr.8043, datë 30.11.1995 të sipërpërmendur dhe vendimit nr.7, datë 31.1.1996 të Gjykatës Kushtetuese - nuk ka bërë publike largimin e tij si bashkëpunëtor i Sigurimit të Shtetit para datës 31 mars 1991.

Gjykata Kushtetuese çmon se kolegji civil i Gjykatës së Kasacionit, nocionin e ligjit "larguar vetë në mënyrë publike", e ka interpretuar gabim dhe në mënyrë shumë të ngushtë, duke mos marrë parasysh se veprimtaria e kërkuesit kundër vijës zyrtare me anë shkrimesh publike dhe diskutimi të

hapur në Konferencën e Shkrimtarëve të Rinj, ka karakter tërësisht publike, të një rëndësie të veçantë dhe tregon në mënyrë të qartë se kërkuesi është larguar vetë publikisht nga detyra e informatorit.

Në këtë mënyrë, duke interpretuar dhe zbatuar gabim ligjin nr.8043, datë 30.11.1995, kolegji civil i Gjykatës së Kasacionit, ka cënuar të drejtën kushtetuese të kërkuesit për t'u zgjedhur, të parashikuar në nenin 19 të ligjit Kushtetues "Të Drejtat dhe Liritë Themelore të Njeriut", nr.7692, datë 31.3.1993.

PËR KËTO ARSYE:

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, duke u bazuar në nenin 24 (pika 3) të ligjit nr.7561, datë 29.4.1992 "Për disa ndryshime e plotësime në ligjin nr.7491, datë 29.4.1991 "Për dispozitat kryesore kushtetuese", më shumicë votash,

VENDOSI:

1. Shfuqizimin e vendimit nr.9, datë 25.4.1996 të kolegjit civil të Gjykatës së Kasacionit.
2. Shfuqizimin e vendimit nr.5, datë 9.4.1996 të Komisionit Shtetëror për Kontrollin e Figurës së Zyrtarëve dhe Personave të tjerë.

Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi menjëherë.

MENDIMI I PAKICS:

Jam kundër vendimit të shumicës për këto arsye :

1. Me shumicë votash është vendosur që kërkesa e Preç Zogajt të kalonte për gjykim në seancë, vetëm për të konstatuar nëse vendimi i Gjykatës së Kasacionit (që ia kishte refuzuar kërkesën bërë kundër vendimit të Komisionit të Verifikimit të Figurave të Zyrtarëve dhe Personave të tjerë, në mbrojtje të shtetit demokratik që e kishte njohur, në bazë të ligjit jo të merituar për të vënë kandidaturën për deputet në zgjedhjet e 26 majit, të vitit të kaluar) kishte ose jo zhvilluar një gjykim të rregullt e ligjor, ashtu si e kërkon neni 38 i ligjit Kushtetues "Për të drejtat dhe liritë themelore të njeriut".

2. Gjatë gjykimit, doli se pretendimi i tij se ish-Sigurimi i Shtetit kishte dosje në ndjekje të tij, nuk ishte verifikuar nga Gjykata e Kasacionit. Kështu për këtë shkak, gjykata u tërhoq për konsultim. Mirëpo, në vend që të vendosej se si duhej bërë në lidhje me atë fakt, shumica vendosi menjëherë shfuqizimin e vendimit të Gjykatës së Kasacionit dhe të vendimit të Komisionit për Kontrollin e Figurës nëse i gëzon ose jo kushtet për t'u kandiduar si deputet, megjithëse në gjykimin e çështjes komisioni as që njoftuar, pra edhe nuk iu dha mundësia të sqarojë se në çfarë të dhënash është mbështetur që ka dhënë vendimin e tij dhe as deri kur ankuesi e ka vazhduar aktivitetin e tij si bashkëpunëtor i ish-Sigurimit të Shtetit, kusht ky primar për t'u marrë parasysh në dhënien e vendimit pro ose kundra.

3. Shumica duke mos i patur parasysh sa sipër, i vlerësoi vetë provat në kundërshtim me atë se si ishin vlerësuar nga Gjykata e Kasacionit.

4. Vlerësimi i provave me ligj i është lënë vetëm Gjykatës së Kasacionit dhe jo Gjykatës Kushtetuese.

ANËTARI
H. Dakli

MENDIMI I PAKICES

Unë, Rustem Gjata, kryetar i Gjykatës Kushtetuese dhe unë, Halil Kopani, anëtar i Gjykatës Kushtetuese, të mbetur në pakicë, nuk mund të pajtohemi me mënyrën e zgjidhjes së çështjes në vendimin përfundimtar nga shumica e anëtarëve, për arsyet e mëposhtme:

Kolegji civil i Gjykatës së Kasacionit, në vendimin e tij nr.9, datë 25. 4.1996, ka pranuar se

kërkuesi Preç Zogaj " ...me aktivitetin e tij ka vepruar kundër vijës zyrtare para datës 31 mars 1991". Por, ajo Gjykatë, këtë fakt e ka quajtur të pamjaftueshëm dhe e ka rrëzuar kërkesën e tij me arsyetimin se në zbatim të ligjit nr.8043, datë 30.11.1995 (shkronja "c" e nenit 2) duhej ta kishte bërë publike largimin e tij si bashkëpunëtor i Sigurimit të Shtetit para datës 31 mars 1991.

Shumica e Gjykatës Kushtetuese, duke e quajtur të gabuar interpretimin dhe zbatimin e ligjit nr.8043, datë 30.11.1995 nga ana e Kolegjit Civil të Gjykatës së Kasacionit, ka vendosur shfuqizimin e vendimit të asaj Gjykate për shkak të cenimit të së drejtës kushtetuese të kërkuesit për t'u zgjedhur, parashikuar nga neni 19 i ligjit kushtetues për "Të drejtat dhe liritë themelore të njeriut".

Mendojmë se kjo mënyrë e zgjidhjes së çështjes nuk gjen mbështetjen e duhur kushtetuese dhe për më tepër, duke vendosur vetë në fakt, e ka shndërruar, në këtë rast, Gjykatën Kushtetuese në instancë të katërt të sistemit gjyqësor.

Gjykata kushtetuese, është e autorizuar të bëjë interpretimin e ligjeve të zakonshme vetëm kur ato vihen përballë normave kushtetuese, për të përcaktuar kushtetutshmërinë e tyre. Interpretimin e dispozitave ligjore e bëjnë vetë gjykatat e sistemit gjyqësor gjatë zbatimit të tyre për çështjet konkrete që shqyrtojnë. Në veçanti, Gjykata e Kasacionit është ngarkuar të shqyrtojë bazën ligjore të vendimeve e akteve të gjykatave më të ulëta e organeve të tjera.

Duke vepruar si më sipër Gjykata Kushtetuese i ka njohur vetes të drejtën të shfuqizojë çdo vendim të Gjykatës së Kasacionit, kur çmon se kjo e fundit ka bërë interpretim të gabuar të ligjit në një çështje konkrete.

Duke u mbështetur në materialet e çështjes, të administruara nga Gjykata e Kasacionit, del se një nga dy pretendimet kryesore të kërkuesit si para komisionit administrativ për verifikimin e figurave, ashtu edhe në Gjykatën e kasacionit, ka qenë se gjatë viteve 1989-1990, është ndjekur (survejuar) si kundërshtar i regjimit. Këtë pretendim e ka mbështetur në të dhënat nga persona që kanë qenë me përgjegjësinë ish-organet e sigurimit si dhe në buletinet zyrtare të Ministrisë së punëve të Brendshme. Por, ky pretendim i tij nuk është marrë parasysh.

Pikërisht në mospërfilljen e këtij pretendimi qendron shkelja e garancisë kushtetuese për një gjykim të drejtë, parashikuar në nenin 40 të ligjit Kushtetues nr.7692, datë 31.3.1993 për "Të drejtat dhe liritë themelore të njeriut". Kolegji civil i Gjykatës së Kasacionit ishte i detyruar të verifikonte deri në fund pretendimin e kërkuesit, pasi ishte me rëndësi thelbësore për nxjerrjen e përfundimit të drejtë e të saktë lidhur me faktin a ishte larguar vetë kërkuesi në mënyrë publike nga veprimtaria e fshehtë e ish-Sigurimit të Shtetit.

Në këto kushte, Gjykata Kushtetuese, duke patur në kompetencë shqyrtimin e i kushtetutshmerisë së vendimeve të gjykatave të sistemit gjyqësor, duhej të vendoste shfuqizimin e vendimit të Gjykatës së Kasacionit si antikushtetues për shkak të cenimit të garancisë kushtetuese të personit për një gjykim të drejtë dhe të urdhëronte rishqyrtimin e çështjes dhe në asnjë mënyrë nuk duhej ta gjykonte vetë çështjen në fakt.

Tiranë, më datë 17. 6.1997

ANËTAR
H. Kopani

KRYETAR
R. Gjata